

UDHËZIM
Nr. 51, datë 3.11.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 46, DATË 20.10.2014 “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I
SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA” NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 34, 36 dhe 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; vendimin nr. 668, datë 15.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit, në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2014-2015”, vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, dhe vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e udhëzimit nr. 46, datë 20.10.2014, ndryshon si më poshtë:

“3. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” të bëhen pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, nga data 20.10.2014 deri në datën 17.11.2014.”.

2. Germat “a” dhe “b” të pikës 4 të udhëzimit, ndryshojnë si më poshtë:

“a) Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse ose me vërtetimin përkatës, sipas përcaktimeve në paragrafin e dytë të pikës 5 të këtij udhëzimi, në një program të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja, me listat me numrat e matrikullimit.”.

3. Pika 6 e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“6. IAL-të private, deri në datën 31 dhjetor 2014, dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të dhënat mbi regjistrimet dhe transferimet e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 22.2.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore”.”.

4. Germat “a” dhe “b” të pikës 9 të udhëzimit, ndryshojnë si më poshtë:

“a) Kanë përfunduar në Republikën e Shqipërisë me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse ose me vërtetimin përkatës, sipas përcaktimeve në pikën 11 të këtij udhëzimi, në një program të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it, ose janë në proces njësimi.”.

5. Pika 11 e udhëzimit, ndryshon si më poshtë:

“11. Për të realizuar aplikimit, kandidati që regjistrohet në ciklin e dytë të studimeve, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin e parashikuar në pikën 10 të këtij udhëzimi;
b) Fotokopje të diplomës së njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë;

c) Për kandidatët që kanë përfunduar studimet në IAL-të publike, në mungesë të diplomës, IAL-të pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetimin në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njësuar me origjinalin të kartonit të diplomës, sipas përcaktimeve në pikën “b” të këtij neni;

d) Për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, vërtetimin e njësimit në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS-i, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopjen e diplomës të njësuar me origjinalin ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës. Në rast se nuk janë përfunduar procedurat e njësimit, kandidati dorëzon një vërtetim që konfirmon dorëzimin në MAS të dokumentacionit të parashikuar për njësimin e diplomës së ciklit të parë, dhe brenda 45 ditëve dorëzon vërtetimin përkatës të njësimit.”.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla